

**RREGULLORE E MBLEDHJEVE TË ASAMBLESË
SË PËRGJITHSHME
TË DHOMËS KOMBËTARE TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**

**Neni 1
Objekti i rregullores**

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave mbi organizimin dhe zhvillimin e mbledhjeve në Asamblesë të Përgjithshme të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, si dhe në zgjedhjen e organeve drejtuese të saj, në zbatim të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat.”

**Neni 2
Njoftimi për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

1. Njoftimi për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme bëhet nëpërmjet njoftimit direkt për anëtarësinë e Dhomës në adresat elektronike të vetëdeklaruarra prej përmbaruesve, si dhe nëpërmjet një njoftimi publik.
2. Njoftimi publik bëhet në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, dhe/ose në çdo faqe tjetër publike që evidenton aktivitetin e Dhomës Kombëtare, përfshirë rrjetet sociale që administrohen nga vetë Dhoma.
3. Njoftimi i anëtarësisë aktive kryhet jo më pak se 7 ditë kalendarike para datës së caktuar për zhvillimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.
4. Për zgjedhjen e organeve drejtuese të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë dhe/ose ndryshime të Statutit të saj, njoftimi i anëtarësisë aktive kryhet jo më pak se 15 ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes.
5. Njoftimi sipas këtij neni përmban të paktën:
 - a) rendin e ditës; orën dhe vendin dhe/ose mënyrën alternative të zhvillimit të mbledhjes që mënyrën online (platforma elektronike);
 - b) shënimin që anëtarët e Dhomës duhet të paraqiten në ditën, vendin dhe orën e caktuar me mjet identifikimi (pasaportë ose kartë identiteti) dhe me dokumentin e identifikimit me të cilin i ka pajisur Dhoma sipas ligjit.
6. Në rastin e mbledhjeve që zhvillohen në distancë/online, anëtarët aktivë të Dhomës, ndjekin udhëzimet e dërguara individualisht apo të bëra publike, për identifikimin/logimin dhe/ose aksesin në platformën përkatëse elektronike të siguruar nga Dhoma, përmes së cilës organizohet mbledhja.

**Neni 3
Thirrja e Asamblesë**

1. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë bëhet nga Kryetari i Dhomës.

2. Të drejtën për të kërkuar mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme e ka edhe 1/3 e anëtarëve aktivë të saj dhe/ose Këshilli Drejtues i Dhomës.
3. Në çdo rast, kërkesa për mbledhjen i drejtohet Kryetarit të Dhomës, i cili brenda 30 ditëve kalendarike është i detyruar të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
4. Në rast se kryetari i Dhomës nuk thërret mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme brenda afatit 30-ditor, 1/3 e anëtarëve aktivë të Asamblesë dhe/ose Këshilli Drejtues i Dhomës, njoftojnë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sipas nenit 2 të kësaj rregulloreje.

Neni 4

Zhvillimi i mbledhjes

1. Në datën dhe në orën e caktuar, 3 përfaqësues të organeve drejtuese të Dhomës dhe/ose stafit mbështetës administrativ, do të bëjnë regjistrimin paraprak të pjesëmarrësve përpara se ata të hyjnë në sallë.
2. Pjesëmarrësi paraqitet në këndin e caktuar dhe deklaron të dhënat e tij, duke paraqitur mjetin e identifikimit personal dhe dokumentin e identifikimit me të cilin i ka pajisur Dhoma sipas ligjit.
3. Një kopje e listës së anëtarëve të Dhomës Kombëtare është e afishuar në vendin e caktuar.
4. Personi i ngarkuar pajis përmbauesit gjyqësorë me fletëhyrjen përkatëse, të cilën përmbauesi e vendos në vend të dukshëm.
5. Në kryesinë e seancës do të jetë kryetari i Dhomës dhe në mungesë të tij nënkryetari.
6. Nëse në rendin e ditës është parashikuar të zhvillohet veprimtari zgjedhore, atëherë mbledhja kryesohet nga përmbauesi gjyqësor privat më i vjetër në moshë ose profesion dhe një noter i Dhomës së Noterisë Tiranë, të cilët do të ndjekin të gjithë veprimtarinë zgjedhore, pa pasur të drejtën e votës.
7. Pas prezantimit, bëhet votimi i rendit të ditës nga anëtarët e pranishëm në sallë.
8. Çdo përmbaues gjyqësor privat që dëshiron të marrë fjalën apo të diskutojë mbi çështje të përfshira në rendin e ditës, duhet të regjistrohet në sekretarinë e Dhomës, e cila asiston në mbledhje, para fillimit të punimeve, me përjashtim të rasteve kur bëhet fjalë për çështje procedurale.
9. Lista e diskutuesve i njoftohet kryesuesit të mbledhjes.
10. Diskutimet fillojnë sipas rendit të ditës dhe vijnë në kryhen sipas radhës së regjistrimit.
11. Koha e diskutimeve nuk mund të kalojë 60 minuta në total për çdo çështje të përfshirë në rendin e ditës, duke u ndarë në minutazh të barabartë për secilin diskutues.
12. Pasi mbyllen diskutimet, për secilën çështje të përfshirë në rendin e ditës, Asambleja e Përgjithshme merr vendim.
13. Vendimet në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, merren me votimin e shumicës së thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm, përfshirë dhe miratimin dhe ndryshimin e Statutit të Dhomës që bëhet me votat e shumicës së të gjithë anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme.
14. Si rregull, votimi në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme bëhet i hapur, përveç rasteve të parashikuara në ligj apo statut.
15. Nëse lidhur me një çështje të caktuar kryetari i Dhomës propozon të bëhet votim i fshehtë, propozimi duhet të miratohet me shumicë të thjeshtë nga të gjithë përmbauesit gjyqësorë të pranishëm.

16. Në rast se në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme votohet për zgjedhjen e organeve drejtuese të Dhomës, atëherë votimi bëhet i fshehtë.
17. Me votim të hapur Asambleja e Përgjithshme cakton komisionin e votimit, i cili më pas menaxhon të gjithë veprimtarinë për zgjedhjen e organeve drejtuese të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.

Neni 5

Mbledhjet në rastet e masave të jashtëzakonshme

1. Në raste të masave të jashtëzakonshme që mund të vendosen për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësive natyrore, kryetari i Dhomës urdhëron që mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të zhvillohen në distancë nëpërmjet mjeteve dhe platformave të komunikimit elektronik.
2. Anëtarësia aktive e Dhomës Kombëtare, në datën dhe orën e caktuar për zhvillimin e mbledhjes mund të mbledhet edhe fizikisht me numër të reduktuar të përmbauesve, në vendet e caktuara nga Dhoma Kombëtare, për të lehtësuar aksesin në mbledhje.
3. Në rastet e zhvillimit të mbledhjeve në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik, sipas parashikimeve të këtij neni, do të respektohen për aq sa mundet rregullat procedurale të parashikuara në rregullore.

Neni 6

Votimi në rastet e masave të jashtëzakonshme

1. Në rastet e masave të jashtëzakonshme, votimi mund të zhvillohet edhe me anë të mjeteve të komunikimit elektronik, duke siguruar identifikimin e përmbauesve të pranishëm dhe ruajtjen e regjistrimit elektronik, sipas rregullave të përcaktuara nga Kryetari i Dhomës.

Neni 7

Etika gjatë punimeve të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

1. Gjatë zhvillimit të punimeve përmbauesit gjyqësorë nuk duhet të ndërpresim fjalën e kryesuesit të mbledhjes apo të diskutuesve të tjerë, të përdorin gjuhë ofenduese dhe joetike, të ndërmarrin sulme personale apo veprime në drejtim të anëtarëve të tjerë, të përhapin informacione që cenojnë jetën private të cilitdo, të sillen në mënyrë të padenjë ose të shkaktojnë rrëmujë gjatë zhvillimit të punimeve.
2. Nëse evidentohen rastet e mësipërme apo çfarëdo situatë që pengon zhvillimin normal të punimeve, kryesuesi tërheq vëmendjen e personit përkatës dhe, në rast përsëritjeje, urdhëron largimin e tij nga salla.

Neni 8

Punimet dhe mbajtja e procesverbalit

1. Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme pasqyrohen në një procesverbal të përmbledhur, ku shënohet data e zhvillimit të mbledhjes, pjesëmarrja e përmbarduesve gjyqësorë, përmbledhja e diskutimeve të bëra, çështjet që miratohen dhe rezultati i votimit.
2. Procesverbali i mbledhjes dhe vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme nënshkruhen nga kryetari i Dhomës dhe në mungesë të tij nga nënkryetari dhe 1/3 e anëtarëve pjesëmarrës të Asamblesë së Përgjithshme.
3. E gjithë veprimtaria për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme e dokumentuar dhe nënshkruar në procesverbal sipas këtij neni, legalizohet edhe nga noteri i pranishëm thirrur nga Dhoma për këtë qëllim.
4. Në rastet kur zhvillohen zgjedhjet për organet drejtuese, procesverbali i mbledhjes firmoset nga komisioni i votimit.
5. Vendimet që merren nga Asambleja e Përgjithshme hidhen në regjistrin e vendimeve që mbahet në arkivën e Dhomës.

Neni 9

Komisioni i Votimit

1. Komisioni i votimit ka në përbërje të tij 5 anëtarë dhe secili kandidat për kryetar të Dhomës ka të drejtë të zgjedhë një anëtar në komisionin e votimit.
2. Nëse numri i kandidatëve është më shumë se 5 (pesë), atëherë të drejtën për të patur anëtar në komisionin e votimit e gëzojnë 5 kandidatët që arrijnë numrin më të lartë të mbështetësve nga anëtarësia ditën e votimit.
3. Nëse numri i kandidatëve është më i vogël se 5, atëherë vendet vakante në komisionin e votimit plotësohen me anëtarë të tjerë të Asamblesë së Përgjithshme, sipas propozimeve dhe miratimit me votim të hapur nga Asambleja.
4. Komisioni i votimit pasi miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Dhomës, fillon punën me administrimin e materialeve për zgjedhjen e organeve drejtuese të Dhomës.
5. Komisioni i votimit mblidhet dhe zgjedh me votë ndërmjet pesë anëtarëve, një kryetar dhe një sekretar të komisionit të votimit. Komisioni i ngritur ka për detyrë të organizojë të gjithë veprimtarinë zgjedhore të Dhomës Kombëtare të Përmbarduesve Gjyqësor Privatë.
6. Komisioni verifikon pjesëmarrjen e anëtarësisë, duke konsideruar anëtarë të Dhomës Kombëtare me të drejtë votimi, përmbarduesin gjyqësor privat të licencuar, të regjistruar në Regjistrin e Përmbarduesve Gjyqësorë Privatë.
7. Komisioni përgjigjet dhe mban përgjegjësinë e zhvillimit të procesit të votimit.
8. Komisioni ka për detyrë:
 - a) të mbajë listën e përmbarduesve votues, duke shënuar emrin, mbiemrin si dhe firmën për marrjen e fletës së votimit;
 - b) të mbikëqyrë votimin, duke mos lejuar shkeljen e rregullave të votimit;
 - c) pasi të ketë mbaruar votimi nga anëtarësia, të bëjë hapjen e kutisë dhe numërimin e votave për çdo kandidat sipas posteve që do të zgjidhen;

- d) për çdo post drejtues që votohet, është i detyruar të mbajë procesverbalin e votimit, duke shënuar votat që ka marrë secili kandidat si dhe votat e tjera të vlefshme ose të pavlefshme si dhe numrin e votuesve.
9. Në fund komisioni shpall me vendim fituesin për çdo post drejtues.
10. Në rast se ka paqartësi, komisioni i votimit i drejtohet konsultimit me rregulloren, me Drejtuesit e Dhomës dhe pavarësisht këtij diskutimi, për çdo rast merr vendim. Komisioni merr vendim me shumicë të thjeshtë votash.

Neni 10

Kandidatët dhe mënyra e shpalljes

1. Komisioni i votimit me marrjen e detyrës i kërkon anëtarësisë të shpallë kandidaturat sipas grupeve të caktuara.
2. Kandidat për organet drejtuese të Dhomës mund të zgjidhet kushdo nga përmbaruesit gjyqësorë privatë të licencuar, të regjistruar dhe në status aktiv.
3. Për t'i dhënë kohë komisionit të përgatisë fletët e votimit si dhe për të njohur anëtarësinë me kandidatët për kryetar të Dhomës, ftohen këta të fundit që në një minutazh prej 5 minutash të paraqesin programin e tyre.
4. Radha e fjalës i jepet kandidatëve nga kryesuesi i seancës (Kryetari i grupit të punës) sipas rendit alfabetik të mbiemrit të kandidatit.
5. Pasi ka përfunduar paraqitja e programeve sipas secilit kandidat për kryetar të Dhomës, komisioni i votimit ka përgatitur fletët e votimit si dhe në mënyrën e përcaktuar në këtë rregullore fton anëtarësinë për të marrë pjesë në votim.
6. Pas votimit për kryetar kalohet në votimin për nënkryetar e më pas për sekretar të përgjithshëm. Pasi janë zgjedhur tre vendet drejtuese bëhet shpallja e emrave për anëtarë të Këshillit Drejtues që janë 7 veta.
7. Kushdo ka të drejtë të propozojë anëtarë për Këshillin Drejtues. Nëse ka grupe, njëri nga përfaqësuesit e grupimit pasi bën prezent grupimin, mund të propozojë në emër të grupit që ai përfaqëson, 7 anëtarët që grupimi kërkon të votohen për anëtarë të Këshillit Drejtues.

Neni 11

Mënyra e votimit

1. Pasi janë përcaktuar emrat e kandidatëve si dhe janë bërë gati fletët e votimit, komisioni i votimit, fton të votojnë përmbaruesit gjyqësorë privatë, të cilët pajisen me fletë votimi, pasi kanë firmosur në listën e votimit për marrjen e tyre.
2. Fleta e votimit ka paraqitjen e fletës së zakonshme në format A4 dhe në fletë është vendosur shënimi “Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, Fletë Votimi”, vendi që votohet dhe më poshtë renditen emrat e kandidatëve që do të votohen si dhe ndarja e cila përcakton votimin me shenjë përkatese.
3. Në votimin për Këshill Drejtues do të vendosen të gjithë emrat e kandidatëve dhe votuesi zgjedh 7 persona. Fleta e votimit duhet të jetë e ndryshme në ngjyrë, në mënyrë që të dallohet nga votimi për secilin vend drejtues që votohet.

4. Votimi bëhet i fshehtë dhe me kuti.
5. Para çdo votimi komisioni i votimit verifikon prezencën në sallë nëse janë mbi $\frac{1}{2}$ e përmbauesve gjyqësorë apo jo. Pas verifikimit të prezencës bëhet fillimi i votimit.
6. Përpara se të mbyllet, kutia e votimit ekspozohet para të pranishmëve për të parë që është bosh dhe pas kësaj mbyllet nga anëtarët e komisionit të votimit.
7. Pajisja me fletët e votimit bëhet në mënyrë të rregullt një nga një dhe pa krijuar radhë ose grumbullime të votuesve.
8. Përmbauesit gjyqësorë ftohen të tërheqin fletët e votimit nëpërmjet njoftimit me zë nga komisioni i emrit dhe mbiemrit të tyre.
9. Në rast se njeri nga përmbauesit për momentin nuk është i pranishëm, ose nuk e dëgjon emrin e tij dhe vjen më pas, ai ka të drejtë të futet në radhë menjëherë pas anëtarit të cilit i është publikuar emri.
10. Pasi ka tërhequr fletën e votimit, anëtari i Dhomës shkon në dhomën e fshehtë ku vendos sipas vullnetit të tij se cilit kandidat do t'i japë votën. Mënyra e votimit do të jetë duke vendosur në kuadratin përkatës të fletës së votimit shenjën + , - , ose X.
11. Për Këshillin Drejtues votimi bëhet duke vendosur shenjën + , - , ose X, në krah të emrave të listuar të kandidatëve që janë në fletën e votimit.
12. Nuk lejohet që votimi të bëhet në mënyrë kolektive, në mënyrë të hapur si dhe nuk lejohet fotografimi ose tregimi i votës. Nëse evidentohen këto raste, komisioni i votimit bën shënimin përkatës si dhe gëzon të drejtë të plota për të shpallur votën e këtij votuesi si të pavlefshme.
13. Pas përfundimit të votimit, komisioni i votimit kalon në numërimin e fletëve të votimit.
14. Në këtë moment komisioni i votimit vendos kutinë e votimit në një vend të dukshëm dhe njëri nga anëtarët e tij hap kutinë dhe duke marrë fletët e votimit një nga një lexon me zë të lartë emrin e kandidatit për të cilin është votuar.
15. Fleta e votimit pasi shihet nga anëtarët e komisionit të votimit vendoset në një vend të dukshëm ku të mos ketë sende ose materiale të tjera.
16. Fletët e votimit për çdo kandidat qëndrojnë të ndara dhe nuk përzihen me njëra-tjetrën.
17. Të gjithë anëtarët e komisionit të votimit janë të detyruar të mbajnë shënim numrin e votave të secilit kandidat. Këto të dhëna komisioni i vendos në procesverbalin e votimit.
18. Procesverbali i votimit firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit të votimit. Mbi bazën e tij më pas komisioni i votimit shpall fituesin nëpërmjet vendimit që ai merr.
19. Vendimi i komisionit të votimit është i shkruar dhe modulari i tij është pjesë e kësaj rregulloreje.
20. Pasi janë marrë nga kutia të gjitha fletët e votimit ajo ekspozohet para anëtarësisë dhe vëzhguesve në sallë për të evidentuar se është boshatisur. Në këtë mënyrë veprohet për të gjithë votimet e bëra.
21. Përmbauesit gjyqësorë ftohen të qëndrojnë deri në përfundim të votimit si dhe të publikimit të rezultateve, por qëndrimi i tyre në sallën e votimit duhet të jetë korrekt dhe pa krijuar probleme.

Neni 12

Mënyra e konsiderimit të votimit për kandidatin fitues

1. Fitues shpallet ai kandidat që merr mbështetjen me votë nga një shumicë e thjeshtë e votave të vlefshme të anëtarëve të pranishëm në votim (50% + 1 të anëtarëve të pranishëm).
2. Në rast se është një kandidat i vetëm, ai shpallet fitues edhe po nuk e arriti shumicën e votave.
3. Në qoftë se në votimin e parë asnjë nga kandidatët nuk arrijnë një shumicë (50+1 të anëtarëve të pranishëm) për të shpallur fituesin organizohet raundi i dytë. Në këtë raund marrin pjesë dy kandidatët që janë radhitur në vend të parë dhe të dytë. Kandidatëve që kanë marrë numër të barabartë votash, u lihet kohë e mjaftueshme të organizojnë një fushatë për të parashtruar programin e tyre për drejtimin e Dhomës.
4. Pasi bëhet votimi i dytë shpallet fitues ai kandidat që merr shumicën e votave të pjesëmarrësve.
5. Në rast se do të kemi barazim të numrit të votave midis kandidatëve, atëherë do të bëhet një raund i ri votimi. Kandidatëve që kanë marrë numër të barabartë votash, u lihet kohë e mjaftueshme të organizojnë një fushatë për të parashtruar programin e tyre për drejtimin e Dhomës.
6. Në këtë rast do të konsiderohet fitues kandidati që ka një numër më të madh të votave se kandidati tjetër.
7. Në rast se dhe në raundin e tretë të votimit kemi përsëri numër të barabartë të votave (barazim), kandidati fitues zgjidhet me anë të shortit që zhvillohet në moment nga komisioni i votimit.

Neni 13

Shpallja e fituesit

1. Pasi janë numëruar votat për secilin post drejtues dhe për të gjithë këtë veprimtari është mbajtur dhe procesverbali përkatës, me vendim të komisionit të votimit bëhet shpallja e fituesve sipas postit për të cilin kandidatët fitues kanë konkurruar.
2. Kandidatët pas shpalljes së rezultatit janë të ftuar të përgëzojnë kandidatët fitues, duke pranuar rezultatin e votimit.
3. Pasi janë shpallur fituesit për kryetarin e Dhomës, nënkryetarin, sekretarin e Përgjithshëm si dhe për 7 anëtarët e Këshillit Drejtues, ata marrin detyrën dhe në bashkëpunim edhe me përmbaruesit e tjerë, kanë përgjegjësinë për vazhdimin e mëtejshëm të funksionimit normal të veprimtarisë së Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.

Neni 14

Procesverbali i votimit dhe dokumentacioni zgjedhor

1. E gjithë veprimtaria për organizimin e proceseve zgjedhore dokumentohet në procesverbal, i cili në fund të veprimtarisë firmoset nga komisioni dhe nga noteri i cili bën legalizimin përkatës.
2. Me zgjedhjen e organeve drejtuese të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, të gjitha strukturat e krijuara më parë marrin masa për kalimin e detyrës me një ceremoni të veçantë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga mbarimi i votimit.

3. Komisioni i votimit të gjithë dokumentacionin e krijuar ka detyrë ta ruajë dhe brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh ta dorëzojë pranë Dhomës Kombëtare.
4. Dorëzimi bëhet në mënyrë të rregullt me procesverbal ku të pranishëm duhet të jenë të gjithë anëtarët e komisionit të votimit.